

UDHËZIM
Nr. 980, datë 15.11.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE MËNYRËS SË PARAQITJES SË
KËRKESËS PËR MIRATIMIN SI PËRDORUES PËR TË USHTRUAR AKTIVITET
BRENDA PARQEVE TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 1.9.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës; dhe të nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”; të kreut I, pika 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 7.7.2023, “Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesit në parqet teknologjike dhe shkencore”.

UDHËZOHJ:

Neni 1
Objekti

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i formës dhe mënyrës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e miratimit si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parqeve teknologjike dhe shkencore.

Neni 2
Përkufizimi

1. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
- a) “Aplikant” është kandidati që ka paraqitur kërkesën për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut;
 - b) “Thirrje e hapur” është thirrja që publikon zhvilluesi në kuadër të procedurës për përzgjedhjen e përdoruesve.

Neni 3
E drejta për të aplikuar në cilësinë e përdoruesit

- 1. Çdo person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, mund të paraqesë pranë zhvilluesit një shprehje paraprake interesi për marrjen e statusit si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor.
- 2. Format i shprehjes së interesit paraprak është sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.
- 3. Shprehja paraprake e interesit mund të dorëzohet në formë elektronike ose shkresore.
- 4. Çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pavarësisht nëse ka dorëzuar ose jo shprehjen e interesit, mund të paraqesë te zhvilluesi kërkesën për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor.

Neni 4
Forma e kërkesës për marrjen e miratimit si përdorues

1. Kërkesa, sipas formatit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin për plotësimin e kërkesave tekniko-ligjore, sipas formularëve të mëposhtëm që i bashkëlidhen këtij udhëzimi:

- a) Formulari 1 – Informacioni ligjoro-administrativ i aplikantit;
- b) Formulari 2 – Formulari i vetëdeklarimit;
- c) Formulari 3 – Studimi i fizibiliteti.

2. Aplikanti, pas njoftimit për paraqitjen e dokumenteve shtesë, dorëzon dokumentacionin e kërkuar nga zhvilluesi i parkut brenda një afati 30-(tridhjetë-)-ditor.

Neni 5

Mënyra e paraqitjes së kërkesës dhe afatet e aplikimit

1. Aplikantët për marrjen e miratimit si përdorues për të ushtruar aktivitet në parkun teknologjik dhe shkencor, duhet të paraqesin:

- i) kërkesën;
- ii) formularët që i bashkëlidhen kërkesës;
- iii) dokumentacionin e kërkuar nga Zhvilluesi në Thirrjen e Hapur.

2. Aplikantët mund të dorëzojnë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në formë elektronike ose shkresore, sipas përcaktimeve në Thirrjen e Hapur.

3. Zhvilluesi i parkut teknologjik dhe shkencor rezervon të drejtën për të kërkuar informacione të mëtejshme mbi dokumentacionin e dorëzuar nga aplikanti.

4. Aplikantët mund të kërkojnë sqarime në lidhje me dokumentacionin e aplikimit në adresën *e-mail* të zhvilluesit, si dhe mund të vizitojnë hapësirën ku do të zhvillohet parku teknologjik, në përputhje me mundësitë teknike të zhvilluesit.

5. Aplikimet duhet të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar nga Zhvilluesi në Thirrjen e Hapur.

Neni 6

Përfshirja e një institucioni të arsimit të lartë

1. Parashikimet në këtë udhëzim zbatohen dhe për përfshirjen në park të një institucioni të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, të akredituar sipas legjislacionit përkatës të vendit të origjinës.

Neni 6/1

Subjektet e ngarkuara për zbatim

(Shtuar me udhëzimin nr. 5, datë 1.9.2026)

Ngarkohet struktura përgjegjëse për parqet teknologjike dhe shkencore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe çdo person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, i cili ka fituar statusin e zhvilluesit të Parkut Teknologjik dhe Shkencor, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

ANEKS 1
FORMATI I SHPREHJES SË INTERESIT PARAPRAK

SHPREHJE INTERESI PARAPRAKE

Data: [shto ditën, muajin dhe vitin]

Për: [shto emrin e Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor]

Nga: [shto emrin e subjektit që shpreh interesin]

Të nderuar,

Ne, të nënshkruarit, _____ (emri i subjektit), me numër regjistrimi të biznesit _____, me seli në adresën: _____, paraqesim shprehje interesi paraprake për marrjen e statusit si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor [shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor] dhe deklarojmë se:

Parashikimet: Ne parashikojmë të aplikojmë për marrjen e statusit si përdorues të [shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor] duke aplikuar mbi bazën e vlerësimeve paraprake si vijojnë:

i. nga veprimtaritë e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____, [shto vendimin e Këshillit të Ministrave që jep miratimin për hapjen e parkut teknologjik dhe shkencor] parashikojmë të kryejmë: _____ (rendit veprimtaritë);

ii. numri i punonjësve që do të angazhohen në këto veprimtari parashikohet të jetë _____ punonjës;

iii. të ardhurat vjetore nga veprimtaria në [shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor] parashikohen të jenë _____ lekë/euro.

Rezerva: Kjo shprehje interesi paraprake jepet pa asnjë detyrim nga ana jonë për paraqitjen e një aplikimi për marrjen e statusit si përdorues i [shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor] dhe asnjë detyrim ligjor nuk do të rrjedhë prej saj.

Me nderime,

[emër, mbiemër i përfaqësuesit të autorizuar të subjektit]

Nënshkrimi _____

Adresa _____
[numrin e rrugës/qytetin ose adresën e qytetit/vendit]

FORMATI

**KËRKESË PËR MIRATIMIN PËR TË USHTRUAR AKTIVITET BRENDA PARKUT
TEKNOLOGJIK DHE SHKENCOR NË CILËSINË E PËRDORUESIT**

Data: *[shto ditën, muajin dhe vitin]*

Për: *[shto emrin e Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor]*

Ne, të nënshkruarit, paraqesim kërkesën për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor *[shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* në cilësinë e përdoruesit dhe deklarojmë se:

Rezerva: Ne kemi shqyrtuar dhe nuk kemi rezerva për kushtet dhe kërkesat e kërkuara/shpallura nga *[shto emrin e Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* në cilësinë e Zhvilluesit të Parkut Teknologjik, për përzgjedhjen e përdoruesve të cilët do të ushtrojnë aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor.

Konflikt interesi: Nuk kemi konflikt interesi në përputhje me *[shto referencën e vendosur nga Zhvilluesi në Thirrjen e Hapur]*

Pranueshmëria: Ne plotësojmë kërkesat tekniko-ligjore për fitimin e statusit të përdoruesit në përputhje me kushtet e vendosura nga Zhvilluesi në Thirrjen e hapur;

Angazhimet: Ne angazhohemi të marrim përsipër sa vijon *(të listohen të gjitha kushtet e përzgjedhjes së përdoruesit të vendosura nga Zhvilluesi):*

- i. _____;
- ii. _____.

Përgjashtimi nga detyrimet: Ne e kuptojmë që Zhvilluesi, pa asnjë detyrim ndaj aplikantëve, mund të anulojë procesin e përzgjedhjes në çdo kohë dhe se nuk është i detyruar të pranojë asnjë aplikim që mund të marrë dhe as të ftojë aplikantët si përdorues të parkut.

Vërtetësia dhe saktësia e informacionit: Të gjitha informacionet, deklaratat dhe përshkrimet e përfshira në kërkesë janë në të gjitha aspektet të vërteta, të sakta dhe të plota në bazë të njohurive tona më të mira. Ne, autorizojmë Zhvilluesin që të verifikojë informacionin dhe dokumentet bashkëlidhur me aplikimin.

Nënshkrimi _____ *[shëno nënshkrimin(et) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit]*

Emri [shtoni emrin e plotë të personit që nënshkruan aplikimin]

Në cilësinë e _____ *[shëno cilësinë e personit që nënshkruan aplikimin]*

I autorizuar për të nënshkruar aplikimin për dhe në emër të: _____ *[shënoni emrin e plotë të aplikantit]*

Adresa _____ *[shëno numrin e rrugës/qytetin ose adresën e qytetit/vendit]*

Datë _____ *[shëno numrin e datës, muajit, vitit]*

Formularët që i bashkëlidhen kërkesës për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor

FORMULARI 1
INFORMACIONI LIGJOR-ADMINISTRATIV I APLIKANTIT

(Për t'u plotësuar nga aplikanti)
Data: [shto ditën, muajin, vitin]
Emri i Parkut: [shto titullin]

Faqe [shto numrin e faqes] prej [shto numrin total] faqet

Emri i aplikantit [shto emrin e plotë]
Informacioni i përfaqësuesit të autorizuar të aplikantit Emri: [shto emrin e plotë] Adresa: [shto rrugën/numrin/qytetin ose qytetin/shtetin] Numrat e telefonit: [shtoni numrat e telefonit, duke përfshirë kodet e shtetit dhe të qytetit] Adresa e postës elektronike: [shënoni adresën e postës elektronike]
Sektori në të cilin aplikanti ushtron veprimtarinë:
Një përshkrim i shkurtër i aktivitetit të aplikantit, me theks në pajtueshmërinë me llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në këtë park:
1. Bashkangjitur janë dokumentat si vijojnë: a) ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e aplikantit, si dhe ekstraktin për historikun e aplikantit; b) dokumente të tjera shtesë që mund të kërkojnë nga Zhvilluesi Kur aplikanti për përdorues është person fizik, juridik, i huaj, duhet të paraqesë dokumentin zyrtar, i cili vërteton se aplikanti është i regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë ose dokumente të ngjashme, të lëshuara nga institucionet përkatëse në shtetin e origjinës. Dokumentet e siguruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të notifikuara, në zbatim të legjislacionit në fuqi për ligjërimin e dokumentacionit të shtetasve të huaj që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Nënshkruar [shtoni nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit në çdo faqe].

FORMULARI 2
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT
(Shfuqizuar shkronja “a” dhe “b” me udhëzimin nr. 5, datë 1.9.2026)

(Për t'u plotësuar nga aplikanti)
Data: [shto ditën, muajin, vitin]
Emri i Parkut: [shto titullin]

Deklarata për veprimtarinë e aplikantit
Aplikanti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Aplikanti nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Aplikanti nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Aplikanti nuk i nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme: a) shfuqizuar;

b) shfuqizuar;

c) në kapitalin e autorizuar të të cilit 25 për qind ose më shumë janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga persona juridikë të regjistruar, të shpallur në listën e financuesve të terrorizmit;

ç) kur ai shpallet i falimentuar në përputhje me dispozitat në fuqi të ligjit për falimentimin;

d) kur është në proces likuidimi, përveç transformimit.

Nënshkruar [shtoni nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit në çdo faqe].

FORMULARI 3 STUDIMI I FIZIBILITETIT

(Forma dhe përmbajtja e studimit të fizibilitetit që do të dorëzohet nga aplikanti përcaktohet nga Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor)

1. Studimi i fizibilitetit duhet të trajtojë të paktën çështjet e mëposhtme:

a) përshkrimi i aktivitetit teknologjik dhe inovativ që propozon të kryejë aplikanti;

b) përputhshmëria e veprimtarisë së aplikantit me llojin e aktiviteteve që kryhen në park, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave që autorizon hapjen e parkut;

c) kapaciteti financiar dhe menaxherial i aplikantit për realizimin e veprimtarisë së propozuar;

d) angazhimet, në lidhje me plotësimin e kriterit/ve të pjesëmarrjes së aplikantit në cilësinë e përdoruesit, në park, sipas përcaktimit në thirrje, pagimin e tarifave të shërbimeve apo çdo kërkesë tjetër të thirrjes.

e) plani i kohëzgjatjes së aktivitetit dhe mundësia e zgjerimit të tij;

f) përfitimet që merr aplikanti nga statusi i përdoruesit në parkun teknologjik;

g) aspektet ligjore dhe rregullatore që prekin aktivitetin e aplikantit;

h) risqet e identifikuara dhe plani i masave të zbutjes së tyre.

2. Zhvilluesi në thirrje mund të përcaktojë të tjera çështje që duhet të përfshihen në studimin e fizibilitetit.